LIGJ
Nr.9814, datë 4.10.2007

PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.8788, DATË 7.5.2001 "PËR ORGANIZATAT JOFITIMPRURËSE"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SE SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në ligjin nr.8788, datë 7.5.2001 "Për organizatat jofitimprurëse", neni 40 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 40
Lehtësimi dhe përjashtimi nga detyrimet fiskale

Organizatat jofitimprurëse, pavarësisht nga format e organizimit, qëllimi që ndjekin dhe veprimtaritë që ushtrojnë, përjashtohen nga tatimi mbi të ardhurat, që realizojnë nga dhurimet dhe kuotat e anëtarësisë.
Të ardhurat e realizuara duhet të destinohen për veprimtari, për të cilat organizata është regjistruar, në rast të kundërt, veprimtaria vlerësohet fitimprurëse dhe i nënshtrohet tatimit.".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5491, datë 10.10.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi